

Përkthimi i dialogëve

Mësimi 1

Kjo është një ide e shkëlqyer!

Në një studio të Radios Deutsche Welle, redaktori dhe prezantuesit e emisionit po lexojnë letra të dëgjuesve për tri pjesët e para të kursit të gjermanishtes.

Andreas: A ka reagime për kursin e gjuhës?
Redaktori: Po, kemi marrë shumë letra nga dëgjuesit.
Dr.Thürmann: E çfarë shkruhet në letra?
Redaktori: Nuk mund t'i lexoj të gjitha. Do të duhej shumë kohë.
Hanna: Jo të gjitha, por disa - ju lutem!
Zonja Berger: Po, edhe unë jam e interesuar !
Redaktori: *(me përtesë)* Po mirë.
Folësi: Por ju lutem -bjerini shkurt!
Redaktori: Ja një letër nga zoti Kard nga Amerika - Një minutë. *(shfleton në grumbullin e letrave dhe lexon me zë)* „Më pëlqejnë aventurat e Andreas - si sportelist në Hotel Europa.“
Andreas: Edhe mua.

Eksës i intereson vetëm se çfarë kanë shkruar për të.

Redaktori: *(shfleton letrat)* Dhe ja një letër nga Anxhela nga Kolumbia. Ajo shkruan: „Jam shumë e lumtur që e studiova gramatikën. Tani e kuptoj kallëzoren e gjermanishtes - ajo ka qenë gjithmonë...“
Ex: *(E ndërpret)* Gramatikë, gramatikë, kallëzore...Po kjo është e mërzitshme. A nuk shkruajnë dëgjuesit ndonjë gjë për mua?
Redaktori: Çfarë mendojnë dëgjuesit për mua? Këtë dua të di unë !
Nuk ka problem, Eksa! Këtu është një letër nga Anglia. Ka diçka për ty. *(e lexon me zë)* „The introduction of Ex is a brilliant idea.“
Ex: *(e inatosur)* Nuk e kuptoj. Ç'do të thotë kjo në gjermanisht ?
Redaktori: Ti je një ide e shkëlqyer!
Ex: Ide? Si mund të jem unë një ide? Unë jam unë!

Disa dëgjues kanë shkruar se nuk e kuptojnë mirë zërin e Eksës. Dhe ekipi i përgatitjes së emisionit diskuton mundësitë e modifikimit të zërit të saj.

Redaktori: Kjo është shumë e rëndësishme. Shumë dëgjues shkruajnë se e kanë të vështirë ta kuptojnë mirë zërin e Eksës.
Andreas: Po ne mund t'i japim asaj një zë tjetër.

Redaktori: Ta provojmë! Eksa, thuaj diçka!
 Ex: Sapo të dëgjoja fjalën magjike, unë duhet ta lija librin dhe ...
 Redaktori: Ok! Stop! Edhe njëherë, të lutem!
 Ex: Sapo të dëgjoja fjalën magjike, unë duhet të lija librin dhe ...
 Dr.Thürmann: A nuk mund të mbetet zëri i saj fare normal?
 Redaktori: Jo – Eksa është një person i veçantë, një vitore e vogël. Pra, ajo duhet të ketë një zë të veçantë.
 Ex: Kështu mendoj edhe unë!
 Redaktori: Po ky është një problem teknik. Do ta zgjidhim më vonë.

Mësimi 2

Çfarë do të dëshironit të bënit?

Zonja Berger ka ftuar në Hotel „Evropa“ Andrean dhe Hanën. Ajo ka marrë një vendim të rëndësishëm dhe dëshiron t'ua thotë.

Andreas: Dëgjo, e di ti pse dëshiron të flasë zonja Berger me ne?
 Hanna: Jo – s'e kam idenë! Por di pse unë dua të flas me të.
 Andreas: Edhe unë!
 Zonja Berger: *(byn)* Gëzohem që keni ardhur të gjithë!
 Ex: Si të gjithë? Mua ajo nuk më pyeti, nëse do të vija ...
 Zonja Berger: Eksa, të dëgjoja se ç' the. Më vjen keq, natyrisht që edhe ti je e mirëpritur! Pra, unë kam marrë një vendim të rëndësishëm.
 Andreas: *(me zë të ulët)* Tani po bëhen punët interesante! *(me zë të lartë)* Edhe unë, zonja Berger.
 Hanna: Edhe unë duhet t'ju them patjetër diçka.
 Zonja Berger: Një minutë, Hana, një minutë.
 Hanna: Po është diçka shumë e rëndësishme. *(shpërthen)* Do të martohem. Dhe dua ta ndërpres punën.
 Zonja Berger: Po, kjo është vërtetë surprizë.
 Andreas: As unë nuk mund të punoj më këtu. Tani i përfundova studimet dhe kam një ofertë të mirë për punë.
 Hanna: Ç'lloj pune?
 Andreas: Do të shkruaj reportazhe për landet e reja në Lindje të Gjermanisë.
 Zonja Berger: Interesante – tamam atje dua të shkoj edhe unë.
 Andreas: Më falni?
 Hanna: Çfarë ?

Zonja Berger ka në plan që të largohet nga Abeni dhe të hapë një hotel të ri në Gjermaninë Lindore. Por ajo nuk di se ku.

Andreas: Zonja Berger, tani më në fund është radha juaj të flisni. Jam i interesuar të di se ç' do të bëni ju.
 Zonja Berger: Fare thjeshtë. Kam qëndruar kaq gjatë në Ahen, i njoh qytetin dhe njerëzit këtu. Tani dua të hap një hotel të ri.

Hanna: Po ku?
 Zonja Berger: Diku në landet lindore të Gjermanisë- ndoshta në Ishullin e Rygenit, ose në Lajpcig, ose ...
 Andreas: Në Lajpcig? Në qytetin e lindjes së dr.Tyrmanit?
 Zonja Berger: Nuk e di nëse dua të shkoj përsëri në një qytet. Dua kohë ta mendoj. Më duhet kohë për të parë se ku.
 Andreas: Dhe ju keni një shoqërues udhëtimesh për t'ju ndihmuar. Mund të udhëtoni kudo dhe të shikoni për një hotel të ri, unë do të bëj udhëtime dhe do të shkruaj reportazhe.
 Ex Po unë? Do të më marrësh me vete?
 Andreas Vetëkuptohet!

Mësimi 3

Brandenburgu: Ujë, rërë dhe patate

Andrea ka shkruar një reportazh për landin federal të Brandenburgut.

Andreas: Ndoshta edhe ju e njihni - Portën e Brandenburgut në qendër të Berlinit! Dhe Berlini ndodhet në qendër të Landit të Brandenburgut, të cilin do t'ua paraqesim sot. Hajdeni me ne, në udhëtimin tonë nëpër Brandenburg !

Landi i Brandenburgut do të përfitojë nga fakti se Berlini, kryeqyteti i Gjermanisë ndodhet në zemër të tij.

Andreas: Është e qartë se Brandenburgu do të përfitojë nga Berlini, kryeqyteti i Gjermanisë. Berlini do të bëhet sërish i rëndësishëm, nga pikëpamja politike dhe ekonomike - jo vetëm për Gjermaninë, por edhe për Evropën.

Në shekullin e 18-të, mbreti i Prusisë, Fridrihu i Madh (1712-1786) ndërtoi një pallat në Potsdam. Këtu ai ftonte shumë artistë dhe filozofë të kohës.

Andreas: Këtu jemi në Potsdam, në kryeqytetin e Brandenburgut. Në këtë vend ndodhet një pallat i bukur. Quhet Sans Souci, në frëngjisht, që do të thotë „pa telashe“. Pallati është ndërtuar në shekullin e 18-të, në kohën e Mbretit Fridrihu i Madh. Ai e donte artin, filozofinë, letërsinë frënge, muzikën. Pothuajse gjithmonë ai shkruante në frëngjisht. Në pallatin e tij ai ftonte Volterin, i binte flautit dhe kompozonte muzikë - shkurt ishte një jetë si në ëndrra. 200 vjet më vonë, këtu kishte një botë tjetër ëndrrash - kinemaja. Në Babelsberg, pranë Potsdamit ndodheshin kinostudio të mëdha. Këtu u prodhuan shumë filma të famshëm.

Brandenburgu është një rajon i njohur për prodhimet e tij bujqësore. Në Republikën Demokratike Gjermane, fshatarët punonin tokën, por ata nuk e kishin atë pronë të tyre. Pas ribashkimit të Gjermanisë, më 1990, tokat që qenë shtetëzuar më 1947, u kthyen sërish në pronësi private.

- Fshatari: Mollë, mollë të mrekullueshme nga Havelland-i. Nuk do të donit ca mollë?
- Andreas: Po, me qejf. (*kafshon një mollë*) Vërtet, paskan shije të mirë. Është bukur këtu- me të vërtetë idilike.
- Fshatari: Po, por gjendja nuk është fare idilike.
- Andreas: Pse kështu?
- Fshatari: Shumë njerëz në Brandenburg kanë jetuar gjithmonë me bujqësi. Kur ekzistonte Republika Demokratike Gjermane, shteti kujdesej për ne. Toka i takonte shtetit- nuk kishte pronësi private, por ne fshatarët mund të jetonim me punën tonë. Që nga viti 1990 toka kaloi sërish në pronësi private - dhe konkurrenca është e fortë.

Mbreti Fridrihu i Madh futi kultivimin e patates, që në atë kohë ishte ende e panjohur në Evropë.

- Andreas: Dhe ja ku jemi tani pranë lumit Oder. 250 vjet më parë, Mbreti Fridrihu i Madh i urdhëroi fshatarët të kultivonin pataten. Atij iu desh t'i urdhëronte ata ta bënin këtë, sepse atëherë askush nuk e njihje pataten. Por para se të fillonin kultivimin, ata duhej të drenazhonin, të thanin dhe kullonin tokën. Për këtë, atyre iu desh gjashtë vjet.

Në vitet '50, në lindje të Brandenburgut u ndërtua një qytet industrial. Ishte një qytet model për Republikën Demokratike Gjermane.

- Andreas: I kemi lënë pjesën veriore të Brandenburgut, fshatarët, ujën dhe patatet dhe kemi ardhur në lindje të landit. Si kudo në Brandenburg, toka këtu është shumë ranore. Ajenhytenshtat është një qytet industrial, i ndërtuar mbi rërë. U vendos që Brandenburgu të mos jetonte krejtësisht nga bujqësia, por të industrializohej. Dhe kështu, në vitet '50 ndërtuan një qytet të ri, me fabrika çeliku dhe apartamente banimi. 12 mijë njerëz punonin këtu, 50.000 vetë jetonin këtu- deri më 1990. Sot kjo industri nuk ka perspektivë. Shumë njerëz tani janë të papunë.

Mësimi 4

Zoti fon Ribek në Ribek ...

Andrea i tregon Eksas për një poemë të Teodor Fontane-s, një shkrimtari të shquar gjerman që ishte nga Brandenburgu. Zoti fon Ribek ishte një promar i madh tokash, që jetoi në sbekullin e 19-të. Gjithmonë kur vinte vjeshta, ai e kishte zakon t'u jepte fëmijëve dardha nga kopshti i tij.

Ex: Po njerëzit e Brandenburgut? Si janë ata?
 Andreas: Po ti e dëgjovë që në Brandenburg ka pasur shumë fshatarë. Ata e donin tokën e tyre - dhe njerëzit. Dhe për një prej tyre ka një histori të famshme.
 Ex: Një histori me vitore dhe karkanxollë?
 Andreas: Jo, Eksa. Është tregim për një njeri që i donte në mënyrë të veçantë fëmijët e varfër. Çdo vit në vjeshtë ai u jepte fëmijëve dardha, nga pema e dardhës së tij. Kur shikonte një vajzë të vogël, ai i thoshte: „*Lütt Dirn, kumm man röwer, ick hebb'ne Birn.*“ (= *Vajzë e vogël, hajde këtu, unë kam një dardhë për ty.*) Kur shikonte ndonjë djalë, ai i thoshte: „*Junge, wiste'ne Beer?*“ (= *Djalë i vogël, a do një dardhë?*) Këtë ai e bënte çdo vit. Një ditë, plaku e ndieu se së shpejti do të vdiste. I vajti mendja tek fëmijët: kush do t'u jepte atyre dardha, kur të kishte vdekur ai?
 Ex: Pse kështu? A nuk kishte fëmijë ai?
 Andreas: Si jo, Eksa - ai kishte një djalë, por ai ishte shumë dorështrënguar. Kështu që atij i lindi një ide...

Zoti fon Ribek kërkoi që të vendosej një kokërr dardhë në varrin e tij. Pas pak vitesh, mbi varr u rrit një pemë dardhe.

Andreas: Pak para vdekjes, plaku tha: Po të vdes, futni një dardhë në varrin tim. Dhe dëshira ju plotësua. Plaku vdiq dhe fëmijët u dëshpëruan. Askush nuk u jepte më dardha. Pastaj, papritur, tri vjet me vonë, mbi varr u duk një degë e vogël. Dhe pas shumë vitesh, një pemë e mrekullueshme dardhe u rrit mbi varr. Sa herë që aty pranë kalon ndonjë djalë, pema i pëshpërit: „*Junge, wiste'ne Beer?*“ (= *Djalosh, do një dardhë?*) Kur kalon aty ndonjë vajzë, pema pëshpërit: „*Lütt Dirn, kumm man röwer, ick gew di 'ne Birn.*“ (= *Vajzë e vogël, hajde këtej, do të të jap një dardhë*)
 Ex: E vërtetë është kjo?
 Andreas: Kjo është një poemë, Eksa, dhe një histori e vërtetë!

Mësimi 5 Poema u ndalua

Andrea dbe Eksa ndodben në Ribek, ku ka jetuar familja fon Ribek. Ata duan të shohin pemën e dardhës, që përshkrubet në poemën e Teodor Fontanes (shihni mësimin 4). Në fshat ata takojnë një burrë, i cili u tregon shumë gjëra rreth historisë së pemës së dardhës.

Burri: Këtu, pranë kishës qëndronte pema e vjetër e dardhës.
 Andreas: Qëndronte? Po tani, ku është?
 Burri: Tani ajo nuk ekziston më. Para më shumë se 80 vjetëve, ajo u shkatërrua nga një shtrëngatë. Djali i plakut fon Ribek urdhëroi të vinin një unazë hekuri rreth trungut të pemës dhe e vendosi atë në kështjellën e tij. Atje ajo përdorej si një tavëll gjigante cigaresh. Ju mund ta shihni atë edhe sot - në restorantin *Zum Birnbaum*.

Andreas: *(duke treguar me gisht një pemë)* Po kjo pema këtu, ç'është?
 Burri: Atë e kemi mbjellë ne – natën, fshehurazi.
 Ex: Si vitorët Hajncelmenhen?
 Burri: Si, ju lutem? Hajncelmenhen? Jo, ne – disa vetë nga fshati.
 Andreas: E pse fshehtas?

Pastaj burri u tregon një histori të mëvonshme. Ai u thotë se poema e Fontanes u ndalua gjatë kohës së Republikës Demokratike Gjermane (1949-1990). Çdo gjë që të kujtonte pronarët e mëdhenj të tokave konsiderohej e padëshirueshme nga regjimi i RDGJ.

Burri: E pra, dëgjoni. Në socializëm nuk kishte më nevojë për pronarë tokash, për junkerë. Ju e keni dëgjuar shprehjen „Junkerland – ein Bauernland“ (= toka e junkerëve – tokë e fshatarëve). Junkerët u shpronësuan dhe toka iu dha fshatarëve. Asgjë nuk duhej të kujtonte kohët e shkuara. Asgjë nuk duhej të ekzistonte, që të të sillte ndër mend plakun Ribek – madje as një pemë ose poemë e asaj kohe. Pema e dytë thjesht u pre nga ushtarët rusë. Dhe poema shkruar nga Fontane, u ndalua. Për 20 vjet nuk kishte atje asnjë pemë. Dhe pastaj, ne mbollëm një, pikërisht këtu, tamam në vendin e duhur, pranë kishës.

Andreas: Pse tamam në vendin e duhur? Ka edhe ndonjë vend jo të saktë?

Burri: Po, natyrisht! Më 1990, pas kthesës politike, erdhën politikanë nga perëndimi dhe mbollën një pemë dardhe, në kujtim të plakut Ribek. Por, në vend të gabuar.

Ex: Kjo do të thotë se tani janë dy pemë?

Mësimi 6 Pas kthesës politike

*Andrea po bën disa intervista me njerëz të ndryshëm në Brandenburg. Ai i pyet ata se çfarë simbolizon për ta ajo që quhet **Wende**. Fjala gjermane **Wende**, të cilën mund ta dëgjoni dendur kur flitet për Gjermaninë Lindore, ka kuptimin „kthesë, ndryshim“. Ajo përdoret për të karakterizuar procesin e rrëzimit të sistemit komunist në Republikën Demokratike Gjermane më 1989, që rezultoi edhe në bashkimin e dy shteteve gjermane më 1990. Njeriu i parë që pyet Andrea është një i ri, që po mëson profesionin e muratorit.*

Andreas: Ç'kuptim ka kthesa politike në Gjermaninë Lindore për ju?
 Karl: Nuk mund ta them në mënyrë të saktë se ç'do të thotë. Shumë nga shokët e mi janë larguar për në perëndim. Dhe megjithëse shumë prej tyre janë kthyer përsëri, këtu ndihet një zbrazëti. Unë kam ndër mend të qëndroj këtu. Do të përfundoj kursin për murator. Brenda vitit do të kem përfunduar kursin – dhe pastaj shohim e bëjmë.

Njeriu i dytë që interviston Andrea është një i ri, i cili është i gëzuar për lirinë e udhëtimit që ka fituar.

Frank: Është me të vërtetë gjë e madhe. Më në fund unë mund të udhëtoj kudo. Gjithmonë kam pasur interes për vendet e tjera. Kam qenë në Itali dhe në Spanjë. Megjithëse nuk kam shumë para dëshiroj shumë të shkoj në Greqi.

Andrea, më pas bisedon me një vajzë të re, e cila e ka ndërprerë kursin e rrobaqepësisë.

Marion: Kur ndodhi kthesa politike, **Wende**, unë isha në mes të kursit të rrobaqepësisë. Në Republikën Demokratike Gjermane, puna e rrobaqepësit ishte një punë me të ardhme. Dhe pastaj, erdhën rrobat e gatshme nga perëndimi, nga Hong-Kongu dhe vende të tjera, të lira - rroba pa etiketa. E si mund të mendohej që unë t'u bëja konkurrencë? Kështu që u ktheva në shkollë dhe tani po punoj për maturën.

Pas kësaj, Andrea interviston një inxhinier rreth 45 -vjeçar, i cili vendosi të punojë i pavarur.

Burri: Me kthesën politike erdhi kthesa edhe për mua. Në fakt, unë jam inxhinier, pastaj u bëra i papunë, dhe më tej hapa këtë dyqan për fotokopjime. Për këtë në treg kishte një boshllëk të vërtetë. Tani duhet të mësojmë ç'është ekonomia e tregut. Është shumë e vështirë. Megjithëse unë punoj 12-14 orë në ditë, jam i kënaqur. Këtë punë e bëj edhe për fëmijët e mi.

Së fundi, Andrea interviston një grua, e cila ka mbetur e papunë. Ajo është mbi 45 vjeç.

Zonja : Ju pyesni se ç'kuptim pati kthesa politike për mua? Pati anë të mira dhe të këqia. Për të rinjtë është natyrisht e mirë. Ata kanë më shumë shanse dhe mund t'i shprehin opinionet e tyre lirish. Por për ne, veçanërisht për ne gratë, kthesa politike nuk ishte e mirë. Megjithëse jemi mësuar të punojmë, shumë gra të moshës sime nuk mund të gjejnë një punë të re.

Mësimi 7 **Një shoqëri multikulturore**

Zonja Berger dhe Andrea po vizitojnë Lagjen Hollandeze të Potsdamit, të ndërtuar në shekullin e 18-të.

Zonja Berger: A nuk janë të mrekullueshme këto shtëpi të thjeshta, të vjetra?
Andreas: Atje do të donit ta hapnit një hotel?
Zonja Berger: Po, me gjithë qejf! Ky është vend ideal për të hapur një hotel. Kështjella Sanssouci është diku fare pranë dhe atje gjithmonë ka shumë turistë.

Ex: Dhe ata pastaj të gjithë do ta kalojnë natën në hotelin tuaj!
 Zonja Berger: Po. Por kur të restaurohen shtëpitë, ato me siguri do të jenë shumë të shtrenjta. Pra, është një ëndërr e bukur – një shtëpi e vjetër e bukur në Lagjen Hollandeze të Potsdamit . Por është vetëm një ëndërr.

Andreas: *(citon)* Në shtetin tim, çdo njeri mund të jetojë sipas mënyrës së tij!

Zonja Berger: *(qesh)* Mirë, mirë. Kështu tha *Frici i Vjetër*, Fridrihu i Madh, si shenjë e tolerancës. Por që atëherë kanë kaluar më shumë se 250 vjet. Sot nuk është e lehtë të jesh tolerant.

Ex: Po pse, në fakt?

Të tre bisedojnë për emigrantët e shëkuillit të 18-të në këtë pjesë të Gjermanisë. Ata i mirëpritën dhe kulturën e tyre e respektuan.

Andreas: Shikoni, pse nuk është e mundshme për njerëzit sot që të jetojnë ashtu siç duan?

Zonja Berger: Ti e di përgjigjen! Shumë njerëz vdiqën në Luftën Tridhjetëvjeçare. Dhe pas asaj, emigrantët u mirëpritën, me qëllim që të ripopullonin vendin.

Andreas: Po, natyrisht që e di. Dhe njerëzit i trajtonin mirë, kultura e tyre respektohej. Njerëzit ishin tolerantë – ishte realisht një shoqëri multikulturore.

Zonja Berger: E drejtë! Këtu erdhën shumë emigrantë për të jetuar – holandezë, italianë, hebrej, hugenotë (kalvinistë). Vetëm hugenotët ishin 20.000 !

Ex: Hugenotë?

Andreas: Francezë, Eksa. *Frici i Vjetër* e fliste frëngjishten më mirë se gjermanishten ...

Ex: *(me këmbëngulje)* Kush kanë qenë hugenotët?

Andreas: Ata ishin protestantë. Besimi i tyre fetar ishte i ndaluar në Francë, në atë kohë.

Ex: Aha. Kjo nuk më intereson. Kam uri.

Andreas: Do të të blej një qofte ...

Ex: Jo, një salçiqe me kërr!

Mësimi 8

Studiot e UFA-s në Babelsberg

Andrea po rikujton themelimin e studiove të UFA-s në Babelsberg.

Andreas: Pra, muzika ishte shumë e rëndësishme për filmat e atëhershme, të prodhuar në studiot e famshme të Babelsbergut. Më 1917-ën u themelua kompania e filmit UFA. Qeveria gjermane e asaj kohe investoi shumë para për studiot dhe kishin arsye të forta për këtë. Ideja ishte të largonin vëmendjen e njerëzve nga papunësia dhe lufta. Prandaj ata prodhonin filma zbavitës, me shumë muzikë. Shumica e këngëve të këtyre filmave janë

të njohura edhe sot. Për shembull, kënga „Haben Sie schon mal im Dunkeln geküsst“ (= a keni puthur ndonjëherë në errësirë), është shkruar që më 1934.

Ja ta dëgjojmë përsëri.

Por ata donin të bënin më shumë në atë kohë. Ata donin të prodhonin edhe filma të mirë, me qëllim që kultura të njihet më mirë jashtë vendit. Fric Lang, për shembull, arriti ta bëjë këtë më 1927, me filmin e tij „Metropolis“.

Filmat pa zë u pasuan nga filmat me zë.

Andreas: Metropolis ishte akoma film pa zë. Pra, që në kinema të mos ishte shumë heshtje, për të shoqëruar filmin luhej muzikë. Siç thoshte një muzikant në atë kohë: „Në Babelsberg ne bëmë edhe muzikë. Unë isha në studiot atje, dhe luaja muzikë për të frymëzuar aktorët“.

Vetëm tri vjet më vonë, më 1930, kjo nuk ishte më e nevojshme. Lindi filmi me zë. Nazistët e patën edhe avantazhin e këtij zhvillimi. Ata kontrollonin filmat dhe e përdorën zërin për të bërë propagandë politike. Pas vitit 1949, në Republikën Demokratike Gjermane, studiot e Babelsbergut u bënë pronë shtetërore. Qysh nga 1992, ato i përkasin një koncerni franko-gjerman. Ka shpresë se atje do të prodhohen shumë filma. Në këtë mënyrë, filmat evropianë do të fitojnë sërish rëndësi.

Mësimi 9

Një „magjistare e bimëve mjekësore“

Gjatë një sbëtittjeje në një fsbat të bukur pranë lumit Havel, Eksa dhe Andrea takojnë një grua që po mbledh bimë mjekësore.

Ex: Çfarë po bën ajo gruaja atje?

Andreas: Më duket se po mbledh bimë mjekësore.

Ex: Dhe çfarë do të bëjë ajo me to?

Andreas: Nuk e kam idenë! Mund ta pyesim. *(shkon pranë gruas)*
Mirëdita!

Zonja : Mirëdita.

Andreas: Kohë e bukur sot!

Zonja : Po, është e mirë për të mbledhur bimë mjekësore. Këtë punë s'mund ta bësh kur bie shi.

Andreas: *(i tmerruar)* Po ju po mblidhni hithra. Nuk ju djegin?

Zonja : *(qesh)* Jo, po unë kam dorashka!

Andreas: Dhe çfarë bëni ju me hithrat?

Zonja : Çaj! Çaj hithrash! Është shumë i shëndetshëm.

Andreas: *(me dyshim)* Më mirë nuk po flas...

Zonja : Po çaji me hithra me të vërtetë ka shije të mirë. Dhe veç kësaj, është ilaç i mirë. Kurim natyror !!
Andreas: Oh, po, kam dëgjuar për këtë më parë.

Frau u shpjegon atyre vetitë mjekësore të hithbrit. Andrea kujton kobët e shkruara, kur gratë si atë i digjnin si shtriga.

Andreas: Dhe ç'rezultat ka kurimi natyror? Do të doja të shkruaja një artikull për këtë.

Zonja : Natyrisht, më parë duhet të njihni hithrat dhe efektin e tyre.

Andreas: Ç'efekt kanë hithrat djegëse?

Zonja : Në fakt, ju e dini vetë. Ju thatë, që ato të shkaktajnë dhimbje, të djegin.

Ex: Hithrat djegëse të djegin, ato duhet t'i njohësh.

Zonja : Kështu është. Kur vuan nga reumatizma, për shembull, duhet ta fërkoni lëkurën me hithra. Bën mirë.

Andreas: (*me dyshim*) Hm ... Po bimë të tjera mjekësore, a mblidhni?

Zonja : Po, ky është hobi, pasioni im.

Andreas: (*bën shaka*) A nuk bëni jetë me rrezik?

Zonja : Pse kështu?

Andreas: Në të kaluarën, gratë si ju i digjnin si shtriga!

Zonja : Oh, kjo ndodhte shumë kohë më parë!

Andreas: E ç'mendojnë njerëzit këtu në fshat?

Zonja : Disa nga ata më shohin si pak të çuditshme, por askush nuk më shqetëson në të vërtetë. Përkundrazi, njerëzit më thërrasin me përkëdhelje *Kräuterhexe* (= *magjistare e bimëve*)

Ex: Shkëlqyeshëm! Ju jeni një magjistare e vërtetë. Unë jam një vitore.

Zonja : Unë të besoj me gjithë qejf.

Lektion 10

Meklenburg-Pommerania perëndimore: ujë dhe kantiere detare

Pjesa e parë e udhëtimit nëpër Meklenburg - Pomeraninë perëndimore e çon Andream në Müritzsee (Liqeni Myric), që bën pjesë në një zonë natyrore nën mbrojtje.

Andreas: A i dëgjuat? Këtu, në këtë parajsë natyrore mund të dëgjoni zogj të rrallë. Por jo vetëm zogjtë e ndiejnë veten mirë këtu. Ka edhe kafshë të tjera dhe bimë të rralla. Dhe nuk ka këmbë njeriu, në të gjithë këtë vend. Është qetësi e plotë. Jemi në jug të Meklenburg - Pomeranisë perëndimore, që është mbi liqenin Myric ... Liqeni është në qendër të zonës që është

rezervati natyror. Këtu me të vërtetë mund të besosh se "ora në Meklenburg ecën më ngadalë".

Andrea vazhdon udhëtimin për në qytetin e vogël Gystrov, ku ka jetuar e punuar skulptori Ernst Barlah.

Andreas: Kemi ecur më tej, nga natyra tek kultura, drejt qytetit Gystrov. Është një nga qytetet e vogla në Meklenburg-Pomeraninë perëndimore. Gystrov u bë i famshëm për shkak të skulptorit Ernst Barlah. Në katedralen e Gystrov-it ndodhet një skulpturë e varur e një ëngjëlli – një ëngjëll paqeje. Skulpturën e shkatërruan duke e shkrirë në furrë nazistët. Sot në katedrale rri e varur një kopje e këtij ëngjëlli.

Andrea po ecën tani në bregdetin e Meklenburg-Pomeranisë perëndimore, në Rostok. Ky është një qytet i vjetër, i cili në Mesjetë ishte pjesë e Lidhjes Hansa. Kjo ishte një shoqatë e tregtarëve dhe qyteteve, që kishin siguruar një monopol tregtie dhe liri qarkullimi në disa rrugë detare.

Andreas: Jemi në Rostok, një qytet- port në Veri të Meklenburg-Pomeranisë perëndimore. Madje edhe sot mund të shihet që Rostoku ka qenë dikur një qytet i lulëzuar. Që nga shekulli i 13-të e këtej, Rostoku i përkiste Lidhjes Hansa. Lidhja Hansa ishte një shoqatë e shumë qyteteve. Në atë kohë, këto qytete kishin një monopol tregtie, dhe për këtë arsye ishin të pasura. Dhe natyrisht, në ato kohëra kishte edhe shumë piratë. Për shembull, Klaus Shtërtebeker.

Deri në vitin 1990, Rostoku ishte qendra e industrisë së ndërtimit të anijeve të Gjermanisë Lindore. Sot ky sektor industrial është në krizë, si në shumë vende të botës.

Andreas: Deri në kthesën politike, Rostoku ishte porta për në botë për Republikën Demokratike Gjermane, veçanërisht për në Veri dhe në Lindje. 55 mijë njerëz punonin në kantjeret detare. Industria e ndërtimit të anijeve, tani kërcënohet, sepse vende të tjera mund t'i ndërtojnë më mirë anijet. Shpresohet, megjithatë, se Rostoku do të bëhet porta për në jug. Dhe njerëzit i mbështesin shpresat e tyre në turizëm.

Etapa e fundit e udhëtimin e çon Andrean në ishullin baltik të Rygenit, i cili është një vend i njohur pushimi.

Andreas: Rygeni është i bukur – kjo është arsyeja që këtu vijnë shumë turistë. Mijëra turistë kanë vizituar tashmë shkëmbinj të e famshëm gëlqerorë. Dhe kjo i frikëson shumë njerëz në Rygen. Ata merakosen se për turistët do të ndërtohen shumë hotele dhe rrugë të gjera. Ata duan që ishulli i tyre të mbetet i bukur edhe në të ardhmen. A do t'ia arrijnë kësaj?

Mësimi 11

Ishulli i Rygenit

Andrea dhe zonja Berger janë në ishullin balltik të Rygenit. Ata po bisedojnë me zotin Vulf, që është anëtar i grupit lokal (Initiative) për luftën kundër spekulatorëve, të cilët e shkatërrojnë natyrën e ishullit duke ndërtuar hotele luksoze.

- Andreas: Ju jeni anëtar i grupit lokal „Për Rygenin“. Ky grup fitoi Çmimin Evropian të Ambientit në vitin 1992. A mund të na thoni se çfarë keni bërë konkretisht?
- Herr Wulf: Po si jo. Ju e keni parë ishullin tonë. Është i bukur, ka pyje të mrekullueshme, plazhe që shtrihen gjatë. Nuk është shkatërruar akoma. Dhe ne po bëjmë fushatë, që të sigurohemi që ishulli të mbetet i tillë.
- Zonja Berger: Bukur do të ishte!
- Andreas: Kundër kujt ju duhet të luftoni?
- Herr Wulf: E dini, shumë njerëz këtu janë të papunë. Nuk ka fare industri. Dhe pothuajse fare as bujqësi. Njerëzit po i mbështesin shpresat në turizëm.
- Zonja Berger: Atëherë, turizmi do të ishte i mirë për ishullin.
- Herr Wulf: Po edhe jo. Ka disa spekulatorë, që po e shfrytëzojnë situatën për të fituar para. Duan të ndërtojnë hotele të mëdha, sheshe golfi dhe parqe për kohën e lirë. Po kjo e shkatërron natyrën. Dhe kundër kësaj luftojmë ne. Ne duam vetëm një turizëm të qetë, të butë.

Zoti Vulf u flet atyre rreth planeve për ndërtimin e një kantieri tjetër detar në ishullin Rygen, për Meyer-Werft.

- Andreas: Ç'po ndodh me Kantierin Majer?
- Herr Wulf: Po, Majer donte të ndërtonte një kantier gjigant, në Lindje të Rygenit, pikërisht para shkëmbinjve të famshëm. Një sallë shumë të madhe montimi për anije të mëdha, dhe pastaj natyrisht, një rrugë të gjerë, një zonë me të vërtetë industriale.
- Andreas: Por me vende të reja pune, apo jo?
- Herr Wulf: Po, kjo është e vërtetë ! Majer premtoi 2000 vende pune. Premtoi, thashë. E kush do t'i kishte marrë ato? Jo ne, njerëzit e Rygenit. Inxhinierët nga Perëndimi dhe Lindja, por jo ne njerëzit këtu. Veç kësaj, kantieri do ta kishte shkatërruar natyrën: ujin, bimët, peshkun, pemët – gjithëcka !
- Andreas: Kështu që kantieri nuk do të ndërtohet?
- Herr Wulf: Jo, nuk do të ndërtohet.
- Zonja Berger: Po me turizmin, si duken punët?
- Herr Wulf: Turistët - ata vijnë sido që të venë punët. Dhe ata janë të mirëpritur. Po pse të ndërtohen kaq shumë hotele të reja? Ne kemi shumë hotele të vjetra ...
- Zonja Berger: Dhe ata duhen restauruar?
- Herr Wulf: Po, do të ishim shumë të kënaqur për këtë.

Mësimi 12

Klaus Shtërtebeker

Andrea është ende në isbullin e Rygenit. Pikërisht nga ky vend, në shekullin e 14-të, pirati Klaus Shtërtebeker doli në det. Andrea përpiqet të përfytyrojë si dubet të ketë qenë atëherë dhe imagjnon një bisedë midis Klaus Shtërtebekerit dhe kapitenit të tij.

- Andreas: Po qendroj këtu mbi shkëmbinjtë e Rygenit dhe shoh tej në det. Shoh dy anije - dhe po mendoj për Klaus Shtërtebeker, piratin e famshëm. Dëgjoni ! A nuk mund të jenë ata zëra të së kaluarës, nga viti 1388?
- Kapiteni: Ej, Klaus, shikojë atë anijen atje larg! Është madhështore, e madhe dhe e bukur. Një anije hanseatike. Mund të kemi nevojë për të.
- Klaus St.: Ke të drejtë. Vërtet mund të na hynte në punë. *(thërret me zë të lartë)* Përpara, burra. Anija nuk u shpëton dot duarve tona. Anija, ahoi !

Duka i Meklenburgut donte ta ndihmonte kushëririn e tij, mbretin e Suedisë, që ishte burgosur nga mbretëresha daneze. Ai kërkoi ndihmën e piratëve. Ata morën një letër që i lejonte zyrtarisht të kapnin anijet daneze.

- Kapiteni: Klaus, e ke marrë vesh lajmin ? Luftë midis Danimarkës dhe Suedisë!
- Klaus St.: Më thuaj më shumë!
- Kapiteni: Meklenburgasit duan të gjithë që të luftojnë kundër Danimarkës. Dhe ne piratët, gjithashtu! Ne do të marrim leje autorizimi nga meklenburgasit. Duhet të përfitojmë nga ky rast.
- Klaus St.: Dhe si?
- Kapiteni: Ne do t'i çojmë ushqime Stokholmit. Si shpërblim, do të jemi të sigurt në portet e Rostokut dhe Vismarit!
- Klaus St.: A e ke dëgjuar se ç'do të bëjnë piratët e tjerë?
- Kapiteni: Ata do të përfshihen në këtë punë!
- Klaus St.: E ke mirë! Kjo luftë është shansi ynë. Ne do të bëhemi të pasur dhe të fuqishëm. Pra, të nisemi menjëherë për në Stokholm!

Kjo „kontratë“ me piratët ekzistoi për shumë vite, por qytetet e tjera në Lidhjen Hansa e kundërshtonin këtë, sepse piratët po bëreshin konkurrentë të drejtpërdrejtë në tregti.

- Kapiteni: Klaus Shtërtebeker, kam lajme të këqia.
- Klaus St.: Fol, Vigbald!
- Kapiteni: Lufta midis Meklenburgut dhe Danimarkës mbaroi. Qytetet hanseatike e kanë detyruar Meklenburgun t'i japë fund luftës.
- Klaus St.: Po letrat e autorizimit nga meklenburgasit?

Kapiteni: Gjithçka ka mbaruar! Ky mund të jetë fundi ynë. Duhet të mendojmë se ç'duhet të bëjmë.
Klaus St.: Klaus Shtërtebeker nuk heq dorë! Kurrë! Që prej dhjetë vjetësh jam pirat – dhe do të mbetem i tillë!

Mësimi 13 Një klub kanotazhi

Andrea dhe zonja Berger vizitojnë një klub për sportin e kanotazhit në një nga liqenet e Meklenburg-Pomeranisë perëndimore.

Zonja Berger: Shihni, ata po kthehen. Oh, sa me qejf do të vozitja përsëri!
Andreas: Ju ? Të vozitni?
Zonja Berger: Po, dikur kam qenë në një klub lundrimi. Ishte shumë bukur.
Andreas: *(duke bërë sbaka)* Oh, nuk e dija që ishit aq sportive!
Zonja Berger: *(këndon një këngë të famshme lundërtarësh)*

Të rinjtë e klubit vijnë në skelë.

Andreas: Po ktheheni nga një orë trajningu?
Vajza: Po.
Zonja Berger: Sa herë stërviteni në javë?
Vajza: Dy – tri herë.
Andreas: A merrni edhe me ndonjë sport tjetër?
Vajza: Po, natyrisht! Ne vrapojmë, luajmë volejball dhe hendboll. Veç kësaj bëjmë shumë gjëra bashkë: marshime, shkojmë në pishinë, ose mbliidhemi dhe bëjmë muhabet. Ne jemi tamam klub!

Vajza u tregon Andreas dhe zonjës Berger se si kishin ndryshuar kushtet për sportin pas kthesës politike në Gjermaninë Lindore.

Zonja Berger: A merrni pjesë edhe në gara?
Vajza: Do ta bënim me gjithë qejf. Por kjo kushton shumë para. Në RDGJ një gjë e tillë organizohej krejtësisht nga shteti.
Andreas: Po tani, si është puna?
Vajza: Tani ne na duhet ta paguajmë thuajse gjithçka vetë – energjinë elektrike, varkat e reja, vendin ku lëmë varkat – dhe veç kësaj na duhet të paguajmë edhe për garat.
Zonja Berger: Dhe si e bëni këtë?
Vajza: Ne paguajmë një kuotë.
Andreas: Një kuotë anëtarësie?
Vajza: Po. Dhe paratë na i japin prindërit. Pa ata kjo punë nuk do të ecte. Këtë vit morëm pjesë në një garë. Por ne ishim në gjendje të shkëlqyer. Dhe jemi krenarë për këtë.

Mësimi 14

Banimi në shtëpi parafabrikate

Andrea është në Rostok dhe po përshkruan një bllok tipik ndërtesash, që ishte ndërtuar në kohën e Republikës Demokratike Gjermane.

Ex: Brr, sa ftohtë dhe erë është këtu!
Andreas: Po, sot jemi në një vend me të vërtetë të ftohtë. Jini të gëzuar që ndodhjeni në shtëpinë tuaj, para radios. Ne jemi këtu në një qytezë, në Rostok. Ju duhet të përfytyroni një bllok të madh me ndërtesa. Kudo që hedh sytë nuk ka gjë tjetër, veçse blloqe apartamentesh. Dhe të gjitha duken njëllor: me pjesë ballore pa relief, të drejta dhe të larta - nganjëherë edhe 21 kate të larta ! Shtëpitë janë ndërtuar me pllaka betoni, një pllakë betoni mbi tjetrën. Kjo është edhe arsyeja pse kjo është quajtur *Plattenbau* (=ndërtime me pllaka të parafabikuara). Pra, tani jam duke qëndruar në një vend bosh midis dy blloqeve. Do të pres deri sa këtu pranë të kalojë dikush. Jam me fat, ja ku po vjen dikush.

Një grua që jeton në një nga këto apartamente, i flet Andreas për kushtet e jetesës atje.

Andreas: Më falni, a keni pak kohë t'ju pyes për diçka?
Zonja Beimer: Një moment, po. Si është puna?
Andreas: Sa kohë keni që jetoni këtu?
Zonja Beimer: Kam njëzet vjet që jetoj këtu.
Andreas: A ndiheni rehat këtu?
Zonja Beimer: Në të kaluarën po. Mund të dëgjoje gjithçka që flitej matanë murit, por ishim të kënaqur që kishim një apartament, të paktën. Ne kemi jetuar për shumë vite në një shtëpi të vjetër, me banjë të përbashkët dhe ngrohje me sobë. Ishte diçka e madhe për ne, kur morëm apartamentin e ri dhe me ngrohje të vërtetë.
Andreas: Dhe si është gjendja tani?
Zonja Beimer: Qysh nga kthesa politike, gjithçka ka ndryshuar. Qiratë janë bërë më të larta. Paguajmë katër herë më shumë se më parë për qiranë. Veç ngrohjes dhe energjisë elektrike. Dhe pastaj - i shihni plehrat atje? Në të kaluarën kishte një administrator. Ai jetonte këtu dhe kujdesej për gjithçka. Jo, tani këtu nuk është më bukur, unë dua të largohem - po ku të shkoj?

Mësimi 15

Saksonia: Muzikë dhe industri

Andrea është në Lajpcig, një qytet me traditë të vjetër muzikore. Këtu ai gjen gjurmët e kompozitorit Johann Sebastian Bach.

Andreas: *(flet duke dëgjuar muzikë)* Muzikë nga Johan Sebastian Bah. Johan Sebastian Bah ishte një kompozitor i madh. Sot jam në kishën e Shën Tomasit (*Thomaskirche*) në Lajpcig. Johan Sebastian Bah ka jetuar këtu për 27 vjet, që nga 1723 deri sa vdiq. Madje edhe sot këtu ka shumë gjëra që të kujtojnë Bahun. Çdo javë mund ta dëgjoni muzikën e tij në kishën e Shën Tomasit. Mund të vizitoni edhe varrin e tij – ose memorialin e madh të Bahut para kishës. Familja Bah kishte traditë të gjatë në fushën e muzikës dhe Johan Sebastian Bah e çoi atë më tej. Ai kishte shumë fëmijë, 11 djem dhe 9 vajza. Disa nga djemtë e tij ishin gjithashtu muzikantë me famë. Dhe që t'i dallojnë njërin nga tjetri muzikantët në familjen Bah njerëzit gjithmonë u referohen atyre me emra (jo me mbiemrat)

Andrea raporton për Kemnicin, një qendër industriale në landin e Saksonisë.

Andreas: Këtu jam në Kemnic, një qendër industriale në Saksoni. Këtu prodhohen makineri për industrinë. Të gjitha llojet e makinave- makineri bujqësore, lokomotiva, vagona treni. Edhe biçikleta prodhohen në këtë vend. Ka edhe industri kimike. Kjo është e rëndësishme për vendet e punës, por ajri është i ndotur. I ndieni erërat e rënda industriale. Po vazhdoj udhëtimin që këtej, në një qytet të vogël...

Andrea e vazhdon udhëtimin drejt qytetit të vogël, Frajberg, ku argjendi nxirret nga minierat që në shekullin e 12-të.

Andreas: Argjendi nxirret këtu që në shekullin e 12-të. Dhe kjo e bëri Frajbergun dhe Saksoninë të pasur. Kaq të pasur, sa që ata në Frajberg ndërtuan një katedrale. Dhe në katedralen e Frajbergut është një organo e famshme. Qyteti është i pasur, por punëtorët jo. Nxjerrja e argjendit ishte punë shumë e rëndë dhe paguhej pak. Shumë minatorëve u duhej të bënin edhe një punë tjetër të dytë.

Mësimi 16 **Probleme ekologjike**

Doktor Tyrmani është kthyer në qytetin e tij të lindjes në Lajpcig dhe po ia kushton kohën e tij mjekësisë alternative. Andrea dhe Elsa e vizitojnë në shtëpinë e tij.

Dr.Thürmann: Mirëdita, zoti Shefer.

Andreas: Mirëdita, dr.Tyrman.

Dr.Thürmann: Ah, e kujt do t'i kishte shkuar mendja?

Ex: Çfarë ?
 Dr.Thürmann: Tungjatjeta, Eksa, edhe ti qenke këtu?
 Ex: Vetëkuptohet!
 Dr.Thürmann: E kush do ta kishte menduar që ne do të takoheshim sërish këtu një ditë, këtu në Lajpcig, në qytetin tim të lindjes.
 Andreas: Jam shumë i gëzuar për këtë. Si jeni me shëndet?
 Dr.Thürmann: Falemnderit, mirë! Ju kujtohet padyshim që unë hoqa dorë nga klinika ime në Berlin.
 Andreas: Po, më treguat për këtë. Po tani, me se merreni?
 Ex: Ndoshta ai akoma dëshiron të më bëjë të dukshme mua!
 Dr.Thürmann: Ndoshta, Eksa, kush e di? Jo, seriozisht, tani po shkruaj artikuj për mjekësinë alternative .

Andrea ka bërë disa kërkime për mjekësinë alternative dhe ka me vete disa revista për doktor Tyrmanin.

Andreas: Po ju dikur më pyetët nëse mund të bëja kërkime për mjekësinë alternative. Kam gjetur diçka për këtë.
 Ex: Për këtë ne folëm edhe me një magjistare bimësh mjekësore.
 Dr.Thürmann: Vërtet?
 Andreas: Epo ja ... Ju kam sjellë disa revista.
 Dr.Thürmann: *(i shfleton ato dhe lexon titujt)*
 „Shëndeti nga bimët mjekësore“, „Tableta – bimë mjekësore-terapi“, „Gjermania në testin ekologjik“.
 Andreas: E marr me mend! Këtu kudo bie erë gazrash industriale, erë squfuri..
 Ex: Puh, vjen erë!
 Dr.Thürmann: Këtu në lindje ka me të vërtetë probleme të mjedisit. Ajri është i ndotur, ashtu si edhe toka, edhe uji. Kam ende shumë për të bërë.
 Andreas: Dua t’ju them diçka. Kam bërë disa intervista interesante rreth këtij problemi.

Mësimi 17

Një shëtitje nëpër Lajpcig

Doktor Tyrmani i tregon Andreas qytetin e tij të lindjes, Lajpcigun. Në fillim ata shkojnë në Nikolai-Kirche.

Andreas: A bëhen akoma lutjet për paqe?
 Ex: Nuk di të lexosh ti? Po atje është shkruar: Çdo të hënë, ora 17.00 lutje për paqe.
 Dr.Thürmann: Po, kjo traditë vazhdon edhe sot, megjithëse tani vijnë më pak njerëz. Dhe kjo traditë nuk ekziston që prej 1989-ës, ajo ekziston prej kohësh.
 Andreas: Madje edhe gjatë periudhës së RDGJ-së, njerëzit mblidheshin këtu.

Dr.Thürmann: Po, qysh më 1981. Ata takoheshin këtu për t'u lutur dhe për të diskutuar.
Andreas: Dhe më 1989-ën, këto takime u bënë më politike. Njerëzit dilnin në rrugë për të demonstruar për më shumë të drejta. Dhe kjo është e njohur.

Ata bisedojnë për ndërtesën e universitetit, që shqubet midis ndërtesave të tjera në qendër të qytetit. Arkitektura e ndërtesës synon të krijojë idenë e një libri të hapur.

Ex: Ç'është ajo ndërtesë aq e madhe?
Andreas: Është universiteti ... Më të lartë nuk e bënë dot këtu ...
Dr.Thürmann: Kjo është „dhëmballa jonë e pjekurisë“. Vështroje mirë. Ndërtesa synon të krijojë përshtypjen e një libri të hapur.
Andreas: Epo, këtë unë nuk mund ta dalloj.
Ex: As unë!
Dr.Thürmann: Po, për këtë ju duhet të vini mirë në punë imagjinatën.
Andreas: Ndërtesa, në të vërtetë nuk është e bukur, por universiteti ngrihet mbi të gjitha ndërtesat e tjera. Kjo më pëlqen.

Të tre shkojnë në lokalin „Auerbachs Keller“. Ky bar është i famshëm, sepse në të lubet njëra nga skenat e „Faust“-it të Gëtes. Dita njerëz brenda po këndojnë me zë të lartë.

Dr.Thürmann: Oh, jo, a duhet kjo? Nuk mund të këndojnë ata me zë të ulët?

Mësimi 18

Porcelani – ari i bardhë

Gjatë një vizite në Majsën, ku prodhohet porcelani i famshëm, zonja Berger tregon historinë e shpikjes së porcelanit. Alkimisti Fridrih Bëtger pohonte se mund të prodhonte ar.

Zonja Berger: A e dini historinë e shpikjes së porcelanit në Majsën?
Andreas: Jo – por më intereson ta di.
Zonja Berger: Tregimi që do t'ju them tani është i vërtetë. Rreth 300 vjet më parë, këtu jetonte një njeri i quajtur Fridrih Bëtger. Ai kishte një hobi, një pasion, që e kishin shumë njerëz në atë kohë. Ai ia kushtonte kohën e tij alkimisë.
Andreas: Dhe alkimistët kishin një qëllim: ata donin të prodhonin ar.
Zonja Berger: Po, kështu është. Por Fridrih Bëtger e thoshte me zë të lartë se mund ta bënte këtë. Dhe kjo ishte fatkeqësia e tij.
Andreas: Pse fatkeqësia e tij?
Zonja Berger: Sepse mbreti i Prusisë, që e mori vesh, e donte me çdo kusht atë ar.

Fridrih Bëtgerin e burgosën dhe megjithëse ai nuk mundi të prodhonte ar të pastër, ai gjeti mënyrën e prodhimit të porcelanit.

- Zonja Berger: Bëtger u frikësua. Ai përndiqej dhe u arratis në Saksoni për t'u mbrojtur. Kjo ishte fatkeqësia e tij
- Andreas: Ç'i ndodhi atje?
- Zonja Berger: Mbreti i Saksonisë e burgosi atë në kështjellën e tij. Atje Bëtger mendohej të prodhonte ar. Por kjo ishte e pamundur. Kështu që atij iu tha të prodhonte të paktën „ar të bardhë“, siç e quanin porcelanin në ato kohëra. Mbreti i Saksonisë, që i admironte serviset kineze të ngrënies, ishte i vendosur të dinte si prodhoheshin ato pjata. Bëtger u mbajti i burgosur për një vit të tërë. Atëherë ai e zbuloi sekretin. Në janar 1710, mbreti i Saksonisë regjistroi një patentë në mbarë Evropën: një patentë për prodhimin e porcelanit.
- Ex: Fat në fatkeqësi.

Mësimi 19

Saksoni-Anhalt: Natyrë – industri – fe

Andrea po ngjitet në këmbë në Broken, në pikën më të lartë të malit Harc. Nga viti 1952-1989 kjo ishte një zonë e ndaluar për t'u vizituar në Republikën Demokratike Gjermane.

- Andreas: Siç e dini, gjermanët i kanë qejf ngjitjet alpinistike. Edhe unë e pëlqej këtë sport. Kjo është arsyeja që erdha në malet Harc, për t'u ngjitur më në fund në Broken. Kjo zonë, në mes të Ma-leve Harc, ndahej nga kufiri i dy shteteve gjermane. Prej 1952-it deri në fund të 1989 nuk lejohej ngjitja në Broken, ishte e gjitha zonë e ndaluar. Por ato kohëra tani mbaruan.

Andrea e vazhdon udhëtimin për në Bitterfeld, qendrën e industrisë kimike. Kjo zonë ka qenë gjithnjë e njobur për pasuri nëntokësore.

- Andreas: Tani po udhëtoj nga Hale në Biterfeld. Toka këtu është shumë e pasur. Shumë kohë më parë, në mesjetë, në Hale nxirrej kripë. Më vonë filloi nxjerrja e linjtit. Po sot? Megjithëse i kam mbyllur dritaret e veturës, ajri ka erë të rëndë. Do edhe 15 km që të arrijmë në Biterfeld. Por ju mund t'i ndieni erërat e gazërave kimike. Në dhe rreth Biterfeldit ka qenë qendra e industrisë kimike të Gjermanisë Lindore:- këtu prodhoheshin lëndë plastike, plehra kimike, kauçuk dhe të tjera. Gjatë kohës së Republikës Demokratike Gjermane, në këtë vend punonin 300 mijë vetë. Më 1992 ishin vetëm 80 mijë. Por industria kimike duhet të mbetet këtu.

Mbeturinat e prodhuara nga industria kimike e kanë ndotur ambientin e kësaj zone.

Andreas: Ajri këtu është i ndotur. Edhe toka është e ndotur nga mbeturinat e industrisë. Mbeturinat thjesht i linin në vend. Frutat dhe perimet, për shembull, që rriteshin këtu, ishin të helmuara. Njerëzit nuk mund t'i hanin më ato. Madje edhe lumenjtë edhe liqenet janë ndotur dhe njerëzit sëmureshin. Në vitet e fundit ajri është përmirësuar dhe uji është më i pastër. Por përsëri do të duhet kohë e gjatë para se njerëzit të mund të bëjnë këtu një jetë të shëndetshme.

Më 1983, për të përkujtuar 500 vjetorin e lindjes së Martin Luterit, në Wittenberg u fërkëtua një shpatë. Ishte një akt simbolik në emër të paqes. Një dëshmitar kujton:

Sot ne po festojmë 500 -vjetorin e Martin Luterit: 3000 të rinj janë mbledhur para kishës së Luterit. Në mes të turmës është ndezur zjarr me qymyr. Një farkëtar nga Vitenbergu po shkon në mes të turmës, tek zjarri. Ai mban në dorë një shpatë, po e mban lart në ajër. Tani po e vë shpatën në zjarr. Shpata po skuqet. Farkëtari i bie hekurit me çekan.

Një grua thotë: „Çdo njeri ka nevojë për bukën dhe verën. Të ketë paqe dhe jo luftë. T'i kthejmë shpatat në plugje.“

Mësimi 20

„Broken -i është një gjerman“ (Heine)

Zonja Berger dhe Andrea dëshirojnë të shkojnë bashkë në Broken. Atyre u kujtobet poeti Hajnrih Hajne, i cili e krabasonte karakterin gjerman me këtë mal.

Andreas: Eksa, e di ti ç'është një „harter Brocken“?
Ex: Jo.
Andreas: Një punë shumë e ndërlikuar për t'u kryer, „një arrë e fortë për t'u thyer“ ...
Zonja Berger: Brocken-i është i vështirë për t'u ngjitur! Në këmbë atje unë nuk ngjitem!
Andreas: Pse jo?
Zonja Berger: A e njeh Faustin e Gëtes? As Mefistofeli nuk donte të ngjitej në këmbë në malin Broken. Ai donte të ngjitej në Broken mbi shkopinjtë e fshesave të magjistarëve.
Andreas: Po e dini se çfarë ka thënë Hajne?
Zonja Berger: Po! „Broken-i është një gjerman.“
Ex: Ç'donte të thoshte me këtë ?
Andreas: Ai donte të thoshte se Brokeni është aq rrënjësor, sa gjermanët, aq tolerant, por edhe aq romantik i krisur sa gjermanët.
Zonja Berger: Duke qenë se unë nuk jam e krisur, do të marr tani trenin e Brokenit. A do të vini me mua?
Andreas: Natyrisht. Unë kam qenë atje në këmbë.

Drejtuesi i trenit të Brokenit u tregon atyre vendin e shtrigave, ku ato vallëzojnë natën e Walpurgisit, d.m.th. nga data 30 prill deri në 1 maj.

Drejtuesi i trenit: Ngjituni të gjithë! Ngjituni, ju lutem ! Po nisemi. „Unë dua të ngjitem në male“, siç thoshte Hajrih Hajne. Ju e keni më të lehtë se Hajne. Nuk ju duhet të shkoni në këmbë. Dhe ja tani vjen sheshi i shtrigave, i magjistarevc. Ju e dini se më 1 maj shtrigat takohen këtu dhe vallëzojnë. Kështu ishte në kohën e Gëtes. Kështu është edhe sot.

Kjo pjesë është shkëputur nga pjesa e parë e „Faust“-it të Gëtes. Ajo përsëkruan „Walpurgisnacht“, kur sipas bestytisë gjermane, shtrigat kalëronin mbi shkëpinj fshesash.

Mefistofeli: Turret dhe shtyn, rrokulliset dhe rrapëllin!
Fishkëllen dhe ulërin, tërhiqet zvarrë dhe kërcëllin!
Përndritet, vjell zjarr, vjen erë e shkruvbon!
Dorë e vërtetë shtrigash!

Mësimi 21

Qymyri – ari i zi

Andrea po viziton një zonë të Gjermanisë Lindore të shkatërruar nga shfrytëzimi i minierës së linjitit.

Andreas: Keni qenë ndonjëherë në hënë? Jo? As unë. Por si ky peisazhi këtu duhet të jetë edhe në hënë. Për kilometra të tëra rreth e rrotull nuk të zë syri asnjë pemë, as edhe një shtëpi, asgjë. Thjesht një peisazh hëne. Po të mos e kisha parë këtë me sytë e mi, nuk do ta besoja. Ku jam? Jam në një zonë, ku linjiti është nxjerrë për më shumë se 300 vjet - pa preokupimin më të vogël për pasojat tek njerëzit që jetojnë këtu dhe natyra.

Andrea flet me një grua të moshuar. Ajo jeton në një fshat, thua jse të gjithë banorët e të cilit jetonin më parë nga nxjerrja e qymyrit.

Andreas: Fshati është bosh. Vetëm pak njerëz vazhdojnë të jetojnë këtu. Por ata duan të qëndrojnë këtu.

Gruaja e moshuar: Po, unë jam plakë. Kam qenë këtu gjithë jetën dhe këtu dua të qëndroj.

Andreas: Gjithmonë këtu keni jetuar?

Gruaja e moshuar: Kam jetuar dhe punuar. Im atë punonte për uzinat MIBRAG, im shoq punonte po atje, edhe im bir, edhe unë, po kështu.

Andreas: Ç'bënit ju aty?

Gruaja e moshuar: Gjithçka -si burrat! Sikur ta kishit ditur ju në perëndim si punonim ne këtu, ne gratë! Por ne ishim krenare për uzinat dhe për punën që bënim.

Andreas: Qymyri njihet edhe si „ar i zi“. Por ai ka shkatërruar ambjentin, ka shkatërruar shëndetin tuaj!
Gruaja e moshuar: Këtu keni të drejtë. Po është e lehtë ta thuash këtë! Po ç'duhet të bënim ne? Kjo ishte puna me të cilën e siguronim jetesën ne. Nuk kishte asnjë punë tjetër.

Fshati rrezikon të rrënohet plotësisht, për shkak të kolapsit të industrisë së linjtit.

Andreas: Linjiti i ka gllabëruar fshatrat, njëri pas tjetrit.
Gruaja e moshuar: Dhe tani e kemi ne radhën. Djemtë janë larguar! Ah, po të ishte gjallë akoma im shoq. Edhe ai këtu do të jetonte. Unë jam grua plakë dhe unë do të qëndroj këtu derisa të vdes.

Mësimi 22

Tyringeni: zemra e gjelbër

Andrea është në jug të Tyringenit, në Tyringer Wald (Pylli i Tyringisë), në një shteg të njobur për bukurinë e tij.

Andreas: Jam tani në mes të pyllit të Tyringenit – në një shteg të gjatë në zemrën e pyllit të gjelbër të Gjermanisë ... Ky shteg është 168 km i gjatë! Këtu vijnë shumë njerëz për të ekskursione dhe shëtitje të gjata në këmbë. Dhe kur i merr uria, ata shkojnë në kioska dhe blejnë salçice të vërteta të skarës të Tyringenit.

Gëte ka shkruar një poemë të njobur për këtë rrugë të gjatë shëtitjeje.

Andreas: Më parë këtu ka qenë shumë më qetë. Kaq qetë, sa Gëte mendoi për qetësinë e përqetshme – për vdekjen. Dëgjoni poemën që Gëte hartoi për këtë rrugë shëtitjeje më 1780.

Në pjesën më të madhe të historisë së tij, Tyringeni ka qenë i copëtuar politikisht. Por siç raporton Andrea, një gjë e tillë ka pasur edhe të mirat e veta.

Andreas: Tyringeni është një krahinë e vogël. Gjatë gjithë historisë së tij ai ka qenë i copëtuar. Kjo kishte një avantazh të madh: landet e vogla të shumta (që përbënin Tyringenin) kishin shumë pak njerëz për t'i angazhuar në luftë. Dhe për shkak se princat (që sundonin në lande) nuk mund të organizoheshin në luftë, ata bënin diçka të vlefshme. Ata mblidhnin piktura dhe libra, sillnin muzikantë dhe ndërtonin teatro. Në shekullin e 18-të, shumë piktorë, muzikantë dhe poetë të famshëm, si Shiler dhe Gëte, jetonin në dy qytete, në Jena dhe në Vajmar.

Andrea viziton një muze prodhimesh prej qelqi.

Andreas: Jam në një muzeum prodhimesh qelqi dhe kam një ndjenjë shumë të çuditshme. A e dini se sa shumë gjëra mund të bëhen nga qelqi? Qelqi këtu prodhohet që prej 450 vjetësh, në fillim shishe, natyrisht stoli për gra dhe sy kukullash – por edhe sy artificialë për njerëz ... 100 vjet më parë, ata punonin shumë orë, deri natën. 15 orë në ditë, madje edhe të dielave. Sot barra e punës është më e lehtë.

Landi i bukur i Tyingenit ka edhe aspekte më pak të këndshme.

Andreas: Por edhe mbi landin e bukur të Tyingenit ka një hije: që prej vitit 1946, nga minierat në hyrje të Tyingenit, në kufirin me Saksoninë është nxjerrë uran i rrezikshëm. Vërtet se që prej vitit 1990, nga minierat e atjeshme nuk është nxjerrë më uran. Por mbeturinat radioaktive janë ende atje. Dhe ato ende i rrezikojnë njerëzit dhe ambjentin.

Mësimi 23

Miti i Barbarosës!

Andrea i propozon Eksës që të shkojnë në shpellën e Barbarosës.

Andreas: Hajde, Eksa, do të shkojmë në shpellën e Barbarosës.
Ex: Oh, shumë mirë – një shpellë. Edhe vitoret Hajncelmenhen në një shpellë jetonin.
Andreas: Por Barbarosa nuk jeton më. Ai ka vdekur para më shumë se 800 vjetësh.
Ex: Por vitoret Hajncelmenhen jo! Pse quhet ai Barbarosa?
Andreas: Ky nuk është emri i tij i vërtetë. Ai ishte perandori Fridrih i Parë, por italianët e quanin atë Barbarosa.
Ex: E ç'do të thotë Barbarosa?
Andreas: Mjekër e kuqe. Sepse Barbarosa kishte mjekër të kuqe.
Ex: Po gjermanët?
Andreas: Atyre aq u bënte për mjekrën e kuqe – ata e donin perandorin e tyre. Shumë nuk donin as ta besonin që ai kishte vdekur. Besonin se ai ishte akoma gjallë. Ata thoshin se ai vetëm po fle, atje poshtë në Shpellën e Tij dhe se pas ca kohësh ai do të kthehet.
Ex: E kur me saktësi?

Andrea tregon legjendën për Barbarosën.

Andreas: Perandori Barbarosa vdiq papritur. Dhe askush nuk donte ta besonte se ai kishte vdekur me të vërtetë. Dhe kështu i krijua një mit- një mit që shumë njerëz e besojnë edhe sot. Atje poshtë në Shpellën Barbarosa, perandori vazhdon të flerë.

Mjekra e tij e kuqe është rritur dhe e rrethon dy herë tavolinën prej guri në shpellë. Jashtë korbat fluturojnë rreth malit. Njëherë në çdo 100 vjet, perandori dërgon jashtë shpellës së tij një xhuxh: ai duhet të kontrollojë nëse korbat po fluturojnë ende rreth malit. Dhe kur xhuxhi kthehet dhe i thotë se korbat po fluturojnë ende rreth malit, perandori fle edhe për 100 vjet të tjera. Por një ditë Barbarosa – për të cilin njerëzit kanë pritur kaq gjatë – do të kthehet, dhe çdo gjë do të jetë si në kohët e para.

Mësimi 24 Luteri në Vartburg

Andrea imagjnon se si mbërriti Luteri në kështjellën e Vartburgut.

Andreas: Është viti 1521. Martin Luterit, që kërkohet nga Papa dhe perandori, i duhet të merrte arratinë. Në mes të udhëtimit përmes pyllit të Tyringenit, karroca e tij u sulmua papritur. „Ndal! Stop! Kjo është një pritë! Zbrit!“, bërtasin tri burra. „Ndihmë! Çfarë doni nga unë? Unë nuk kam para!“, thotë Martin Luteri. „Hajde me ne – ndryshe je i vdekur!“ iu përgjigjën burrat dhe e tërhoqën Luterin jashtë karrocës. „Ku po më çoni?“, i pyet ata Luteri dhe ata i thonë. „Ne na dërgon një miku yt.“ „Po të çojmë në Vartburg, atje do të jesh më i sigurtë. Që sot e tutje ti do të jesh një murg i thjeshtë – ti nuk do të quhesh më Martin, por Jërg. Pra, murg Jërg, hajde!“ Kështu Luteri u çua në Vartburg, ku qëndroi i fshehur për një vit.

Gjatë një shëtitjeje në Vartburg, shoqëruesi u tregon vizitorëve historinë e një njolle boje të veçantë.

Gruaja: Kjo është dhoma e Luterit. Dhe kjo është tavolina ku punonte ai. Siç e dini, pikërisht këtu e përktheu ai Dhjatën e Re. Iu desh vetëm një vit për ta përkthyer. Vetëm një vit! Natyrisht, ai pati edhe probleme. Jo me përkthimin, por me djallin. Djalli, i cili nuk ishte fare i kënaqur me punën e tij e shqetësonte Luterin. Dhe me qëllim që ta largonte djallin, Luterin mori shishen e bojës dhe ia hodhi djallit. Fatkeqësisht shishja e bojës nuk goditi djallin, por murin. Njollën e bojës në mur mund ta shihni ende.

Ex: Akoma njolla e vjetër e bojës?

Andreas: Shsht, Eksa – jo, natyrisht jo. Njolla u rivizatua për turistët ...

Mësimi 25

Lulja blu

„Lulja blu, luan një rol të rëndësishëm në një roman të shkrimtarit romantik gjerman, Novalis. Ajo është simbol i kërkimit të vetvetes, të egos së njeriut.

Andreas: Të dashur dëgjues! A do të dëshironit të kërkonit një lule blu me ne sot? E kam fjalën për një lule blu të veçantë, për *Lulen Blu*. Ndoshta keni dëgjuar edhe më parë për të. Ajo luan një rol të rëndësishëm në një roman të shkruar gjatë periudhës së romantizmit. Titulli i romanit të shkruar nga Novalis, shkrimtar romantik, është „Hajnrih fon Ofterdingen“. Hajnrih, personazhi kryesor në roman sheh një ëndërr. Ai sheh në ëndërr lulen blu dhe pas kësaj ëndërrë ai fillon ta kërkojë lulen blu.

Dr. Tyrmani sheh një lidhje midis interesit që Novalis tregon për lulen dhe industrisë së minierave.

Andreas: Pas ëndrës, Hajnrihu u përpoq të gjente *Lulen Blu*. Ai kërkoi kudo, udhëtoi anembanë, madje shkoi thellë në mal ...

Dr. Thürmann: Dhe pikërisht kjo më ka interesuar mua – mali.

Andreas: Pse?

Dr. Thürmann: Novalis studiointe gjeologji. Kështu ai e njihte malin dhe pjesën e brendshme të tij. Tani, dëgjo me kujdes. Një vend i veçantë në mal, ku gjendjen shtresa minerare është i njohur si: „Ajzenhut“ (Kapele e hekurit). A të kujton gjë kjo?

Andreas: Hm, jo.

Dr. Thürmann: Mendo për emrin e një luleje!

Ex: Ajzenhut (ajzenhut është e afërt me emrin e bimës helmuese spinner ose kësulën e murgut)!

Dr. Thürmann: E saktë! „Ajzenhut“! Një lule blu, një lule me petale blu. Po ti nga e njeh atë, Eksa?

Ex: *(bën një zburmë sikur po pastron fytin)*

Mësimi 26

Një fjalë magjike

Dr. Tyrmani po vret mendjen, nëse mund ta bëjë të dukshme Eksën me ndihmën e bimës së kësulës së murgut, një bimë helmuese. (Emri në gjermanisht për kësulën e murgut është Eisenhut).

Dr. Thürmann: E dini që Ajzenhut është emri i një bime shumë helmuese? Nga kjo bimë ju mund të prodhoni një helm vdekjeprurës ... *(mendon me vete)* Dhe po ta holloni helmin, ndoshta ai mund të sjellë dikë në jetë, dhe më tej ai mund të bëjë dikë të dukshëm...

Ex: Ai do që të më bëjë të dukshme. E dija, që në fillim. Po unë

Dr.Thürmann: nuk dua.Jo, kurrë. Nuk është sëmundje të jesh e padukshme.
Në rregull, Eksa. Ne nuk do të bëjmë eksperimente.
Andreas: Jo, në asnjë mënyrë. Asnjë eksperiment me Eksën time!

Zonja Berger dësbiron të mësojë pse vajti Eksa tek Andrea.

Zonja Berger: Eksa, më intereson të di pse erdhe tek Andrea.
Ex: Sepse ai tha fjalën magjike.
Andreas: Si të lutem? Unë kam thënë një fjalë magjike? Nga e di ti këtë,
Eksa?
Ex: Nga vitoret Hajncelmenhen.
Andreas: Pra, ti i i ke takuar ato?
Ex: Po, një nga ato.
Andreas: Dhe cila është fjala magjike?
Ex: E nga ta di unë!

*Fjala magjike, që Andrea tha pa e ditur është **sowieso** (= vetëkuptohet, sido që të jetë)*